



**RAPORT NGA MONITORIMI  
I TESTIT KOMBËTAR  
TË MATURËS 2015**

**AFATI I QERSHORIT 2015**







---

**RAPORT NGA MONITORIMI  
I TESTIT KOMBËTAR  
TË MATURËS 2015  
AFATI I QERSHORIT 2015**

---

Qershor 2015



---

**DREJTOR I INTERNEWS KOSOVA:**

Faik Ispahiu

**AUTORË:**

Muhamet Hajrullahu dhe Faik Ispahiu

**REDAKTORË DESKU:**

Përparim Isufi, Ervin Qafmolla, Bekim Muhaxheri, Parim Olluri

**ZYRA LIGJORE:**

Furtuna Sheremeti dhe Kreshnik Gashi

**UDHËHEQËS I DESKUT PLANIFIKUES:**

Muhamet Hajrullahu

**MENAXHERE E PROJEKTEVE:**

Albulena Sadiku

**REDAKTOR I RRJETEVE SOCIALE:**

Valon Canhasi

**LEKTURA:**

Mehdi Mulaj

**MONITORUESIT E TESTIT TË MATURËS:**

Amire Qamili, Granit Mavriqi, Labinot Leposhtica, Denis Sllovinja, Qazim Hasanaj, Rrahman Ramaj, Fitore Aliu, Albulena Sadiku, Florina Ujupi, Behar Mustafa, Naser Fejza, Skender Govori, Jeton Ispahiu Erjonë Popova, Valdet Salihu, Lum Ademi, Gresa Musliu, Vjosa Daku, Shkodran Nikçi, Qëndresë Mustafa, Adea Kondirolli, Mehdi Mulaj, Hysen Gara, Armend Zenelaj, Durim Shala, Lekë Muqaj, Arben Pnishi, Petrit Kryeziu, Alfred Kinolli, Kaltrina Rexhepi Astrit Perani, Besa Maliqi, Ardian Gashi, Taulant Racaj, Naim Krasniqi, Fitore Metbala, Paulina Nushi, Visar Kryeziu.

**PËRKRAHJA TEKNIKE:**

Arian Hyseni, Yllka Hoxha, Dardan Sinani, Ramize Hyseni, Ermal Gashi, Eset Dërguti, Basri Shala, Syzana Firza-Puka.

---

---

# PËRMBAJTJA

- 06** PËR KALLXO.COM
  - 07** METODOLOGJIA
  - 09** PËRMBLEDHJE
  - 10** GJETJET E MONITORIMIT TË TESTIT TË MATURËS MË 6 DHE 20 QERSHOR 2015  
Vonesat e fillimit dhe mbylljes së testit
  - 11** ADMINISTRIMI I TESTIT TË MATURËS
  - 13** INTERNET NË SHKOLLËN “FRANG BARDHI” NË MITROVICË
  - 14** PËRDORIMI I TELEFONAVE CELULARË DHE SJELLJA E MATURANTËVE
  - 15** PËRGJIGJET E TESTIT SHPËRNDAHEN NË MËNYRË MASIVE ONLINE
  - 16** PENGIMI NË PUNË I EKIPEVE TË KALLXO.COM
  - 17** REKOMANDIMET
  - 18** PUBLIKIMET NË LIDHJE ME MONITORIMIN E TESTIT TË MATURËS 2015
-

## PËR KALLXO.COM

Platforma online [www.KALLXO.com](http://www.KALLXO.com) është projekt i përbashkët i organizatave Internews Kosova (I/KS), Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), OJQ-së “LENS” dhe Agjencisë Kundër Korrupsion (AKK), ndërsa përkrahet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me mbështetje të SDC.

Platforma KALLXO.com ofron mundësinë për të gjithë qytetarët që të raportojnë rastet e korrupsionit, krimit të organizuar, mashtrimit, konfliktit të interesit si dhe të gjitha rastet e tjera të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, neglizhencës, mos punës, rrezikimit të të drejtave të qytetarëve të Kosovës, apo rrezikimit të interesave të përgjithshme.

Internews Kosova (I/KS) është organizatë joqeveritare, e themeluar në vitin 1999 nga një ekip i guximshëm vendor dhe ndërkombëtar. I/KS është organizatë e pavarur e cila që nga themelimi i vet është angazhuar në zhvillimin e mediave të pavarura, gazetarisë hulumtuese dhe demokratizimit të shoqërisë në Kosovë e rajon.

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) është organizatë mediale e specializuar për gazetari hulumtuese, monitorim të shërbimeve publike dhe transmetime televizive.

I/KS në bashkëpunim me BIRN-in prodhon emisionet “Jeta në Kosovë” dhe “Drejtësia në Kosovë”, publikon online Gazetën “Jeta në Kosovë” dhe boton gazetën e vetme në gjuhën angleze në Kosovë “Prishtina Insight”. Gjithashtu, Internews Kosova dhe BIRN-i monitorojnë shërbimet publike si dhe zgjedhjet lokale e parlamentare në Kosovë.

## METODOLOGJIA

Internews Kosova (I/KS) dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Huluntuese (BIRN) kanë monitoruar për të dytin vit me radhë Testin e Maturës Shtetërore përmes vizitave të Qendrave të Testimit, vrojtimit, audio dhe video regjistrimit të gjendjes dhe situatës, mbajtjes së shënimeve dhe intervistave me nxënës, prindër, qytetarë, administrues zyrtarë nga radhët e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT) dhe Drejtorive Komunale për Arsim (DKA).

Duke pasur parasysh se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT) ishte në përgatitje të Provimit Shtetëror të Maturës, i cili do të mbahej si pjesë e procesit të rregullt mësimor, si dhe duke pasur parasysh që Internews Kosova e BIRN-i kanë ndërtuar platformën KALLXO.com për raportim të korrupsionit dhe dukurive negative në Kosovë dhe duke u bazuar në përvojën që Internews Kosova dhe BIRN-i kanë krijuar në raportim dhe monitorim të proceseve të rëndësishme përmes raportimit të paanshëm e kredibil, si dhe duke konsideruar nevojën e bashkëpunimit kualitativ të shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare mbi bazën e barazisë dhe të përfitimit të ndërsjellë, u pajtuan përmes një Marrëveshjeje për Bashkëpunim që edhe këtë vit të bëhet monitorimi i Testit të Maturës nga ekipet e KALLXO.com.

Sipas kësaj marrëveshjeje, MAShT-i do të ftojë të gjithë maturantët, mësimdhënësit dhe qytetarët e Republikës së Kosovës që të shfrytëzojnë platformën KALLXO.com për të raportuar parregullsitë eventuale gjatë procesit të administrimit të Provimit Shtetëror të Maturës.

MAShT-i, sipas kësaj marrëveshjeje, do të sigurohej që të gjithë monitoruesit e KALLXO.com do të kenë qasje të papenguar në të gjitha hapësirat e objekteve shkollore në të cilat do të administrohej Provimi Shtetëror i Maturës, si dhe do të krijojë mundësinë për të fotografuar, xhiruar dhe dokumentuar në të gjitha format procesin e administrimit të Provimit Shtetëror të Maturës.

Në anën tjetër, ekipet e KALLXO.com do t'i zbatojnë standardet më të larta të monitorimit dhe raportimit të paanshëm dhe profesional duke mos e penguar procesin e organizimit dhe mbarëvajtjes së Provimit Shtetëror të Maturës.



**Qendrat ku KALLXO.com e ka monitoruar Testin e Maturës më 6 dhe 20 qershor 2015:**

**DEÇAN:** “Vëllezërit Frashëri” dhe “Tafil Kasumaj”;

**FERIZAJ:** Gjimnazi “Shaban Hashani”, Shkolla fillore “Gjon Serreçi”, Shkolla teknike “Pjetër Bogdani”, Shkolla e bujqësisë “Zenel Hajdini”, Gjimnazi “Kuvendi i Arbërit”, Shkolla ekonomike “Faik Konica”, Shkolla fillore “Jeronim de Rada”;

**GJAKOVË:** Shkolla fillore “Yll Morina”, objekti i Fakultetit “Fehmi Agani”, Shkolla fillore “Zekeria Rexha” (objekti i ri dhe objekti i vjetër);

**GJILAN:** Gjimnazi “Zenel Hajdini”, Gjimnazi i shkencave natyrore, Shkolla e mesme teknike “Mehmet Isai” dhe Shkolla ekonomike “Marin Barleti”;

**ISTOG:** Shkolla nëntëvjeçare “Bajram Curri” (në ‘Qendra 1’ dhe ‘Qendra 2’);

**KAÇANIK:** Gjimnazi “Skenderbeu” dhe Shkolla profesionale “Emin Duraku”;

**KLINË:** Gjimnazi “Luigj Gurakuqi” dhe Shkolla profesionale “Fehmi Agani”;

**LIPJAN:** “Vëllezërit Frashëri” dhe “Adem Gllavica”;

**MALISHEVË:** Gjimnazi “Hamdi Berisha” (përfshi edhe objektin e shkollës fillore “Ibrahim Mazreku”) dhe Shkolla Profesionale “Qendra e Kompetencës”;

**MITROVICË:** “Frang Bardhi” dhe “Hasan Prishtina”;

**OBILIQ:** “Hasan Tahsini” dhe “17 shkurti”;

**PEJË:** Gjimnazi “Bedri Pejani” dhe Shkolla e mesme e arteve aplikative “Odhise Paskali”;

**PODUJEVË:** Shkolla “Shaban Shala” dhe Shkolla e mesme ekonomike “Isa Boletini”;

**PRISHTINË:** “Dr. Ali Sokoli”, “Xhevdet Doda”, “28 Nëntori” dhe gjimnazi “Sami Frashëri”;

**PRIZREN:** “Gjon Buzuku”, Shkolla fillore “Abdyl Frashëri” dhe Shkolla fillore “Fadil Hisari”;

**RAHOVEC:** “Xhelal Hajda - Toni” dhe Shkolla e mesme profesionale “Selajdin Mullabazi – Mici” dhe “12 Maji”;

**SKENDERAJ:** Gjimnazi “Hamzë Jashari” dhe Shkolla e mesme teknike “Anton Çetta”;

**SUHAREKË:** Gjimnazi “Jeta e Re”, Shkolla e mesme teknike “Skender Luarasi” dhe Shkolla profesionale në Shirokë “Avdyl Rama”;

**VUSHTRRI:** Gjimnazi “Eqrem Çabej”, Shkolla teknike “Lutfi Musiqi”, “SHMU 2”, “Ali Kelmendi”, “Naim Frashëri” dhe Shkolla profesionale “Bahri Haxha”;



## PËRMBLEDHJE

Ky raport i paraqet të gjeturat e ekipeve të KALLXO.com gjatë monitorimit të Testit të Maturës për afatin e qershorit 2015.

Testit të Maturës i janë nënshtruar rreth 33 mijë nxënës në 250 qendra të testimit dhe është administruar nga rreth 2,500 administrues, 800 komisionarë dhe 500 mbikëqyrës.

Monitoruesit e KALLXO.com e kanë monitoruar Testin e Maturës në 19 komuna:

Obiliq, Kaçanik, Suharekë, Ferizaj, Skenderaj, Lipjan, Mitrovicë, Gjilan, Malishevë, Prishtinë, Istog, Deçan, Gjakovë, Prizren, Podujevë, Pejë, Vushtrri, Klinë dhe Rahovec.

Ekipeve monitoruese të KALLXO.com janë mirëpritur në shumicën e Qendrave të Testimit dhe stafi administrues kryesisht ka qenë bashkëpunues.

Përjashtim në këtë bëjnë rastet e shkollës "Luigj Gurakuqi" në Klinë, "Marlin Barleti" në Gjilan dhe "Xhelal Hajda- Toni" në Rahovec, kur drejtorët Xhafer Bashota në Klinë, Xhevat Kastrati në Gjilan dhe Igballë Cakaj në Rahovec, kanë refuzuar hyrjen apo ia kanë mohuar mundësinë për të xhiruar ekipeve monitoruese të KALLXO.com.

Pas reagimit të zyrtarëve të MASHT-it, këto situata janë korrigjuar në Klinë dhe Gjilan ku ekipeve të KALLXO.com i është lejuar punë e papenguar së paku në ditën e dytë të testit, për deri sa në Rahovec, zyrtarja Igballë Cakaj, ka refuzuar ta zbatojë marrëveshjen të cilën MASHT e ka nënshkruar për monitorim të KALLXO.com.

Si rezultat i monitorimit janë vizituar 60 qendra të testimit, janë zhvilluar mbi 200 intervista me nxënës, prindër, administrues e zyrtarë tjerë të përfshirë në procesin e testimit.

Po ashtu, janë postuar 47 publikime, 17 tituj të veçantë (më datën 06 qershor), ndërsa më 20 qershor janë publikuar 43 artikuj me 13 tituj të veçantë.

Si pjesë shtesë, Internews Kosova dhe BIRN-i kanë organizuar dhe transmetuar një debat televiziv në emisionin "Jeta në Kosovë" në lidhje me zhvillimet të cilat e kanë përcjellë afatin e qershorit të Testit të Maturës 2015. <http://jetanekosove.com/sq/Debate/-145Jeta-ne-Kosove-146-Diskutoi-per-Testin-e-Matures-1262>

Raportet e KALLXO.com dëshmojnë për një avancim të dukshëm në pjesën përgatitore dhe zbatuese të administrimit të Testit të Maturës. Sipas raporteve nga monitorimi i KALLXO.com, është vërejtur një mobilizim dhe seriozitet më i lartë në insistimin për të siguruar mbarëvajtje të administrimit të Testit të Maturës.

Sidoqoftë, edhe këtë vit janë shënuar lëshime edhe në aspektin administrativ edhe në mbikëqyrjen e Testit të Maturës.

Mbetet sfida të tejkalohen situatat si mungesat ose vonesat e administratorëve, problemet dhe mospërputhja e listave me emrat e nxënësve të cilët kanë të drejtë t'i nënshtrohen Testit të Maturës, e sidomos qartësimi, informimi dhe uniformimi i rregullave të testimit.

Ekipeve tona monitoruese, sikurse edhe vitin e kaluar, kanë vërejtur laramani të aplikimit të rregullave të përcaktuara nga MASHT-i.

Jo vetëm në mes të qendrave të ndryshme të testimit, por edhe brenda një qendre testuese është interpretuar dhe zbatuar në mënyra të ndryshme procedura e identifikimit të nxënësve, mbajtjes së pajisjeve elektronike (telefonave mobil, etj.), vendosjes së çantave, lejimi i papenguar i qasjes në internet, etj.

Problemi më i madh në këtë afat të Testit të Maturës mbetet kopjimi dhe shpërndarja e testit dhe përgjigjeve në rrjetet sociale si dhe reagimi i plogësht i Njësitit Kundër Krimeve Kibernetike në Policinë e Kosovës.

Raporti në vijim përmban detaje nga të gjeturat e raportimit më datat 6 e 20 qershor 2015.

# GJETJET E MONITORIMIT TË TESTIT TË MATURËS MË 6 DHE 20 QERSHOR 2015

## Vonesat e fillimit dhe mbylljes së testit

Edhe këtë vit Testi i Maturës në disa komuna të Kosovës nuk kishte filluar e as nuk kishte përfunduar me kohë.

Testi ka përfunduar me vonesë në shkollat “**Fadil Hisari**” në Prizren (10 minuta vonesë); “**Hamdi Berisha**” në Malishevë (15 minuta vonesë) dhe “**Shaban Hashani**” në Ferizaj (20 minuta vonesë).

Në disa shkolla vonesa kishte ndodhur si rezultat i problemeve me emrat e nxënësive nëpër lista. Në Shkollën e Mesme “**Skender Luarasi**” në Suharekë, kishte mbi 10 maturantë emri i të cilëve nuk figuronte në lista, por të njëjtit më vonë iu nënshtruan testit.

Sipas drejtorit të kësaj shkolle, Gëzim Sopa, arsyeja pse është paraqitur ky problem është kryerja e pagesës me vonesë nga maturantët. Por sipas drejtorit, të gjithë ata që i kanë pasur të kryera pagesat, edhe pse nuk kanë qenë në listë, janë lejuar t’i nënshtrohen testit.

Në Shkollën “**Xhelal Hajda - Toni**” në Rahovec, ekipi i KALLXO.com kishte raportuar në orën 10 e 17 minuta se në disa klasë nuk ka filluar testi për shkak se ende nuk janë shpërndarë materialet. Shkaku i vonesës ishte insistimi i administrueseve për të mos i shpërndarë testet para se të dorëzoheshin të gjithë telefonat nga nxënësit e pranishëm në klasa.

Në shkollën e Muzikës “**Lorenc Antoni**” në Prizren, pjesa e dytë e testit të maturës nuk kishte filluar me kohë. Vonesa ka ndodhur ngase materialet nga MASHT-i kanë ardhur të ngatërruara. Në këtë shkollë kanë ardhur testet e drejtimit të përgjithshëm të gjimnazit.

Pas konsultave të stafit përgjegjës të shkollës me MASHT-in, u vendos që nxënësit ta lirojnë shkollën derisa testet të vijnë nga Prishtina. Drejtori i Arsimit në Prizren, Nexhat Çoçaj, kishte njoftuar se testi në këtë shkollë do të fillojë nga ora 11:30 duke i informuar nxënësit se vonesa do t’u kompensohet.

Po në Prizren, gjatë pjesës së parë të testit të maturës më 6 qershor 2015, testet qenë ngatërruar në Shkollën “**Fadil Hisari**” të kësaj komune.

I njëjti problem është identifikuar dhe publikuar nga monitorimi i KALLXO.com edhe gjatë monitorimit të vitit të kaluar. Prandaj është pritur që DKA në Prizren dhe MASHT-i do të ndërmarrin masa të nevojshme që të sigurohen që kjo ngatërrësë të mos përsëritet.



## ADMINISTRIMI I TESTIT TË MATURËS

Edhe këtë vit monitoruesit e KALLXO.com kanë raportuar për probleme në disa komuna të Kosovës. Në Gjimnazin “**Frang Bardhi**” në Mitrovicë monitoruesit e KALLXO.com kanë raportuar për mungesë administratorësh. Raportimi është bërë në orën 10:15, 15 minuta pasi zyrtarisht duhej të fillonte testi i maturës.

Po ashtu në disa komuna kishte problem me listat e nxënësve të cilët i kishin kryer pagesat për testin e maturës.

Në Lipjan, edhe pse i kishin dorëzuar kopjet e fletëpagesave të bankave, dy nxënës nuk i kanë gjetur emrat në listat e Testit të Maturës. B. K. dhe E. R., maturante të Gjimnazit “**Ulpiana**” në Lipjan hyrja në testin e maturës u është lejuar nga komisioni vetëm pas 40 minutash.

Edhe 11 nxënës që në vitin 2014 nuk e kishin kaluar Testin e Maturës dhe ishin përsëritës të tij, nuk i gjetën emrat në Gjimnazin “**Vëllezërit Frashëri**” në Lipjan. Ata më pas u njoftuan se janë në listat e atyre që do të hyjnë në test në një shkollë tjetër. Komisioni në Gjimnazin “**Vëllezërit Frashëri**” ua lejoi atyre hyrjen në test në këtë shkollë, pasi këtu po e mbanin Testin e Maturës nxënësit e drejtimit të këtyre përsëritësve.

Mos informimi i qartë mbi orarin e fillimit dhe përfundimit të Provimit Shtetëror të Maturës ka bërë që një nxënëse në shkollën “**Shaban Shala**” në Podujevë të ankohet për kohën në dispozicion. Ajo pretendonte se edhe pse i dinte krejt përgjigjet, nuk kishte arritur ta përfundonte provimin për pak minuta, sepse ishin mbledhur fletët e testit 10 minuta para orarit që ajo e dinte si orar zyrtar.

Pas negociatave me administratorin e MASHT-it, është vendosur që kësaj nxënëseje t’i jepen edhe 2 minuta shtesë për ta përfunduar testin.

Në shkollën “**Fadil Hisari**” në Prizren ku e kanë mbajtur Testin e Maturës 256 nxënësit e shkollës së mesme teknike “**11 Marsi**”. Më

datën 6 qershor 2015 pati ngatërime të listave me emrat e nxënësve. Në këtë shkollë kanë shkuar listat me emrat e nxënësve të vitit të kaluar, e jo të atyre aktual.

“Nxënësit janë në listat e Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Shkollës, por në listat e Ministrisë së Arsimit është bërë ngatërresë. Nga Ministria e Arsimit kanë ardhë tjera lista, ndërsa drejtorja dhe shkolla këtu tash na dhanë tjera lista”, tha Qamil Veliji. Me këtë problem është njoftuar edhe drejtori i Drejtorisë Komunale në Prizren, Nexhat Çoçaj, i cili tha se ka reaguar me kohë dhe e ka evituar problemin, duke i siguruar listat e nxënësve të asaj shkolle.

“Është paraqitë mospërputhja e listave dhe aty testi ka filluar me vonesë. Tash është çdo gjë në rregull, por testi ka fillu me 30 minuta vonesë”, u shpreh Çoçaj, duke shtuar se u ka dhënë sugjerime mësime nxënësve që nxënësve t’u kompensohet koha e humbur. Monitorimi i KALLXO.com ka vërtetuar se në pjesën e dytë të afatit të qershorit të Testit të Maturës, ky problem është evituar dhe nuk është përsëritur.

Në gjimnazin “**Luigj Gurakuqi**” në Klinë, një klasë prej 15 nxënësve e kishte përfunduar testin e maturës para kohe. Administruesja e kësaj klase tha se nxënësit e kanë përfunduar testin para kohe edhe pse kanë afat edhe 60 minuta. Testet ishin dërguar në zyrën e drejtorit të shkollës ku ishin edhe anëtarët tjerë të komisionit.

Raste të tillë kur nxënësit e kanë përfunduar testin para afatit të paraparë kanë ndodhur edhe në Shkollën Profesionale “**Fehmi Agani**” të Klinës dhe në shkollën “**Faik Konica**” në Ferizaj.

Administruesit e Testit të Maturës në Gjilan kishin hasur në probleme me identifikimin e nxënësve të cilët janë në listën e atyre që janë zënë duke e keqpërdorë testin në ditën e parë të testimit më 6 qershor.



Ministria e Arsimit kishte bërë të ditur se 67 maturantë nga mbarë Kosova janë përjashtuar nga testi për shkak të keqpërdorimeve gjatë ditës së parë, nga të cilët raportohet se 12 vijnë nga shkollat e Gjilanit.

Në qendrën e testimit në shkollën **“Zenel Hajdini”** në Ferizaj, për shkak të shiut që kishte rënë, nxënësit ishin vendosur brenda në korridore të shkollës pa iu nënshtruar ndonjë kontrolli paraprak.

Në Shkollën e mesme teknike **“Mehmet Isai”** në Gjilan ishte ndier mungesa e tre administratorëve duke shkaktuar problem në tri klasa. Mungesa e administratorëve nga Lipjani ka ndodhur si pasojë e komunikimit jo të saktë me Drejtorinë e Arsimit në Gjilan. Tre administratorët nga Lipjani në vend që të vijnë në Gjilan, janë ndalur në Prishtinë.

Në këtë rrethanë DKA në Gjilan i ka zëvendësuar me profesorët e Gjilanit të cilët nuk ishin të përgatitur dhe nuk i dinin rregullat e testimit. Drejtori i shkollës, Xhevat Kastrati, dhe ai i Drejtorisë për Arsim, Nazmi Musa, kanë thënë se ky problem është evituar shpejt dhe nuk ka shkaktuar ndonjë pengesë apo vonesë. Gjatë intervistës me njërin nga këta mësues të cilët ishin angazhuar në rolin e administruesit në momentin e fundit, KALLXO.com ka mësuar se ky e kishte shumë të vështirë të futet në rrjedhat e testit pasi që nuk ka qenë i parapërgatitur.

Përballë Gjimnazit **“Jeta e Re”** në Suharekë, në lokalet që gjenden afër, është vërejtur një numër i madh i familjarëve të maturantëve dhe një numër i të rinjve, të cilët po mundoheshin t’u ndihmojnë me forma të ndryshme maturantëve që gjendeshin brenda në testim.

Në Shkollën e mesme **“Anton Çetta”** në Skenderaj maturantët kanë mundur të hyjnë në test edhe pa letërnjoftim. Drejtori i shkollës, Bekim Latifi, e konfirmoi këtë për KALLXO.com. “Edhe pse nuk kanë letërnjoftim, ata janë nxënës të shkollës dhe nuk mund të ndalohen në test”, tha Latifi.

Në një klasë në shkollën **“Shaban Shala”** në Podujevë, nxënësit që po i nënshtroheshin testit të maturës ishin lejuar t’i mbajnë çantat e tyre nëpër banka, ndërsa në klasë të tjera ato u janë marrë dhe janë vendosur në një kënd të klasës. Njëjtë ka ndodhur edhe me telefonat e nxënësve.

Mbikëqyrës të kësaj shkolle kanë thënë se nuk i kanë kontrolluar nxënësit nëpër xhepa për t’ua marrë telefonat, por janë shprehur se do të intervenojnë nëse ata bëjnë përpjekje për t’i përdorur telefonat gjatë kohës së testimit.

Në Shkollën e mesme teknike **“Skender Luarasi”** në Suharekë ka pasur probleme me emrat e nxënësve nëpër lista, pasi disa nxënës nuk i kishin emrat në listë, edhe pse i kishin paguar fletëparaqitjet me vonesë. Por ky problem më pas ishte zgjidhur.



## INTERNET NË SHKOLLËN “FRANG BARDHI” NË MITROVICË



Në platformën KALLXO.com disa qytetarë kishin raportuar se në shkollën e mesme “**Frang Bardhi**” në Mitrovicë kishte qasje në internet. Ky raport është vërtetuar menjëherë nga ekipi monitorues i KALLXO.com. Gjysmë ore pas raportimit në KALLXO.com, drejtuesit e shkollës “**Frang Bardhi**” në Mitrovicë e kanë ndërprerë lidhjen e internetit në këtë shkollë.

Monitoruesit e KALLXO.com nga kjo shkollë në Mitrovicë kishin raportuar se dy nxënës të shkollës së mesme “**Frang Bardhi**” në Mitrovicë më datën 20 Qershor ishin përjashtuar nga Testi i Maturës pasi ishin identifikuar se kanë keqpërdorur testin duke e shpërndarë atë në rrjetet sociale në ditën e parë të testimit, më 6 qershor.

Qasje të papenguar në internet kishte edhe në disa shkolla tjera të Kosovës. Në Shkollën e mesme “**Anton Çetta**” në Skenderaj, ekipi i KALLXO.com ka raportuar se ka pasur qasje të

papenguar në internet, por nuk është ndërmarrë kurrfarë hapi lidhur me këtë informatë deri në përfundim të testimit. Drejtori i kësaj shkolle, Bekim Latifi, është arsyetuar se kanë nevojë për qasje në internet.

Ndërsa në Prizren, drejtori komunal i Arsimit, Nexhat Çoçaj, ka konfirmuar për KALLXO.com se janë evidentuar dy nxënës që kishin keqpërdorur testin më 6 qershor, të cilët janë përjashtuar nga testi i datës 20 Qershor. Në ndërkohë Çoçaj ka njoftuar për KALLXO.com se dy personat e evidentuar dalin të mos jenë fare nxënës të asnjë shkolle në Prizren dhe nuk janë të njohur për DKA në Prizren.

KALLXO.com edhe vitin e kaluar kishte zbuluar shpërndarjen masive të testit të maturës në rrjetet sociale, të cilat kanë bërë që Prokuroria Themelore e Prishtinës të hap rast.

## PËRDORIMI I TELEFONAVE CELULARË DHE SJELLJA E MATURANTËVE

Ekipet e KALLXO.com kanë raportuar po ashtu për praninë dhe përdorimin e telefonave celularë gjatë Testit të Maturës Shtetërore.

Paqartësia dhe mungesa e zbatimit të uniformuar, sidomos rreth çështjes së lejimit të telefonave mobil, ka bërë që Ismet Ferizi - drejtori i Gjimnazit “**Frang Bardhi**” në Mitrovicë të merret me njërin nga nxënësit për ta bindur që ta dorëzojë telefonin e tij mobil.

Nxënësi në fillim refuzoi ta dorëzojë telefonin mobil duke thënë se 70% e nxënësve kanë telefona me vete. Drejtori Ismet Ferizi, pa e ngritur zërin dhe duke përdorur vetëm fjalë të mira, arriti t’ia marrë telefonin këtij nxënësi duke bërë që testimi të vazhdojë papengesa.

Në anën tjetër, ekipet e KALLXO.com kanë fotografuar edhe telefona të tjerë të marrë nga nxënësit nëpër komuna tjera të Kosovës.

Në shkollën e mesme “**Zenel Hajdini**” në Ferizaj, njëri nga nxënësit kishte kërcënuar administruesin e Qendrës së Testimit pasi nuk kishte pranuar ta dorëzojë telefonin gjatë testimit. Mbikëqyrësi i kësaj qendre, Sedat Baraliu, tha se rasti është paraqitur në polici dhe i takon policisë të merret më tej me këtë. Ndërsa zëdhënësi i Policisë për rajonin e Ferizajt, Agim Gashi, konfirmoi shoqërimin e një personi në stacionin policor.

Ekipi i KALLXO.com ka dokumentuar raste të përdorimit të telefonave edhe në Rahovec. Në një klasë në gjimnazin “**Xhelal Hajda**”, të paktën një nxënës është filmuar duke përdorur telefon celular.

Monitoruesit e KALLXO.com kanë xhiruar edhe një administrues i cili po e përdorte telefonin e vet përderisa po qëndronte në afërsi të nxënësve që i ishin nënshtruar testimit në shkollën “**Frang Bardhi**” në Mitrovicë.





## PËRGJIGJET E TESTIT SHPËRNDAHEN NË MËNYRË MASIVE ONLINE

Njëri ndër problemet më serioze të Testit të Maturës Shtetërore mbetet kopjimi dhe shpërndarja e Testit të Maturës në rrjetet sociale. Më datën 6 qershor 2015, në platformën KALLXO.com, qytetarët kishin raportuar se përgjigjet e Testit të Maturës Shtetërore në Kosovë po shpërndahen nga grupe të organizuara nëpër mediat sociale.

KALLXO.com kishte raportuar raste të faktuara të shpërndarjes së testeve për shkolla në disa qytete të Kosovës, si Prishtinë, Gjakovë, Gjilan dhe Suharekë. Kanalet e komunikimit që janë përdorur kanë qenë kryesisht Facebook, Viber, Whatsup, madje edhe Twitter.

Disa prej testeve po shpërndaheshin haptazi përmes vegëzave (linqeve) publike. Disa nga komentet në këto komunikime të paligjshme përmbajnë fjali si “jam me do profesora në kafiq”.

Kopjimi dhe shpërndarja e përgjigjeve të Testit të Maturës kishte ndodhur edhe në ditën e dytë të testit më 20 qershor, edhe pse ishte e qartë nevoja për ta luftuar këtë dukuri.

Edhe pse Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës kishte ndërmarrë masa për përjashtimin nga testimi për 67 maturantë për shkak të kopjimit në pjesën e parë të afatit të qershorit, kjo dukuri nuk është ndalur as në pjesën e dytë të këtij afati.

Monitorimi i KALLXO.com ka vërejtur një reagim të plogësht sidomos nga ana e Njësitit për Krime Kibernetike të Policisë së Kosovës, nga i cili është pritur që të jetë në gatishmëri për të reaguar më shpejt dhe më me vendosmëri në raste të keqpërdorimit përmes internetit të testit të maturës.



## PENGIMI NË PUNË I EKIPEVE TË KALLXO.COM

Përkundër marrëveshjes zyrtare me MASHT-in, disa nga ekipet e KALLXO.com ishin penguar për ta realizuar monitorimin. Në shkollën “**Luigj Gurakuqi**” në Klinë ekipi i KALLXO.com më 6 qershor ishte penguar që të monitorojë mbajtjen e Testit të Maturës.

Xhafer Bashota, menaxher i qendrës së testimit dhe drejtor i shkollës “**Luigj Gurakuqi**” në Klinë, kishte këmbëngulur që ekipi i KALLXO.com të mos e monitorojë këtë shkollë edhe pse emrat e të gjithë reporterëve dhe monitoruesve ishin dërguar zyrtarisht nga Ministria e Arsimit.

Ky reagim i Xhafer Bashotës është konsideruar si çështje personale, për shkak të raportimeve të mëhershme kritike të KALLXO.com në lidhje me shkollën të cilën e drejton ai. Sidoqoftë, ekipi i KALLXO.com nuk kishte pasur pengesa të njëjta kur kishte monitoruar këtë qendër testimi më datën 20 qershor 2015.

Ekipi i KALLXO.com ishte penguar edhe në Gjilan. Në shkollën ekonomike “**Marin Barleti**” më datën 6 qershor ekipit nuk i është lejuar monitorimi, pavarësisht marrëveshjes së arritur me MASHT-in.

Xhevat Kastrati, drejtori i shkollës ekonomike “**Marin Barleti**”, së bashku me dy profesorë tjerë, e kanë përjashtuar ekipin e KALLXO.com nga qendra e testimit.

Menjëherë pas kësaj, në vend të ngjarjes ka ardhur Hilmi Retkoceri, kryetar i komisionit të testit për rajonin e Gjilanit, i cili e njoftoi drejtorin Xhevat Kastrati që ekipi i KALLXO.com nuk duhet të përjashtohet nga monitorimi, pasi që këta të fundit kanë leje nga MASHT-i. Ky intervenim ka ndikuar që ekipi i KALLXO.com të mos ketë më probleme gjatë monitorimit.

Në shkollën “**Xhelal Hajda - Toni**” në Rahovec, Igballe Cakaj ka penguar ekipin e KALLXO.com për ta xhiruar atmosferën gjatë testimit më 6 qershor 2015. Ky vendim i Igballe Cakajt ka ardhur pak minuta pasi KALLXO.com ka publikuar një lajm me video, ku shihet një nxënës duke përdorur telefonin e tij gjatë kohës së testit.

Arsyetimi zyrtar i Igballe Cakajt ka qenë që mjeti i përdorur për xhirim nuk është i precizuar në marrëveshjen e arritur me MASHT-it dhe Internews Kosova. Edhe për kundër raportimi të këtij incidenti në MASHT, i njëjti refuzim ka ndodhur edhe në ditën e dytë të testit të maturës me 20 qershor 2015 në shkollat “**Xhelal Hajda – Toni**” dhe “**Selajdin Mullabazi – Mici**”. Ekipi i KALLXO.com nuk ka pasur problem për ta përdorur të njëjtën kamerë në një shkollë tjetër të Rahovecit, në shkollën “**12 Maji**”, ku zyrtarët kanë treguar shkallë të lartë të bashkëpunimit.

## REKOMANDIMET

Ekipi i KALLXO.com e konsideron si inkurajues faktin që shumica e rekomandimeve të Internews Kosova dhe BIRN-it nga monitorimi i Testit të Maturës të vitit të kaluar janë marrë parasysh dhe zbatuar nga MASHT-i.

Si obligim i përgjithshëm nga ky monitorim paraqitet nevoja që të obligohen shkollat që në rast se kanë nxënës me aftësi të kufizuar të cilët bëjnë pagesa dhe dihet se do t'i nënshtrohen Testit të Maturës, të njoftojnë Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë për nevojat e veçanta të tyre dhe të bëhet gjetja e mënyrës më të përshtatshme për mbajtjen e testimit për ta.

Nevoja për një paralajmërim të mëhershëm për të tilla raste është vërejtur, sepse janë hasur rastet e vështirësive të nxënësve me raste të tilla gjatë testimit.

Përpos rekomandimeve nga viti i kaluar, në bazë të monitorimit të KALLXO.com më datat 6 dhe 20 qershor 2015, Internews Kosova dhe BIRN-i i rekomandojnë Ministrinë për Arsim, Shkencë dhe të Teknologji këta hapa:

1. Testi të vazhdojë të zhvillohet në klasa me nga 15 nxënës;
2. Testi të zhvillohet me dyer të hapura;
3. Të shpërndahen me shkrim, me kohë dhe në formë të qartë protokollat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të përfshirë në administrim të testimit, në mënyrë që të jenë të njoftuar dhe të përgatitur në detaje për të gjitha situatat e mundshme që mund të paraqiten gjatë procesit të testimit, për të siguruar një reagim uniform në tërë Kosovën gjatë mbarevajtjes së testimit;
4. MASHT-i të publikojë një listë udhëzimi ku i sqarohet çdo nxënësi në mënyrë të qartë së çfarë do të duhej të mbajë me vete një nxënës gjatë kohës së testimit (p.sh. laps, kalkulator, shishe uji, etj.), dhe të sqarohet se çka e ka të ndaluar të posedojë me vete (p.sh. telefon, materiale të ndryshme, libër, etj.);
5. Të zbatohet në mënyrë të uniformuar rregullorja e MASHT-i për administrim të Testit të Maturës dhe të mos lejohen interpretime të ndryshme të rregullave të njëjta;
6. Përgjegjësia për pjesëmarrje dhe administrim të procesit të testimit të jetë e rregulluar kontraktualisht me të gjithë mësimdhënësit. Angazhimi për administrim të testit të jetë jo në baza vullnetare, por i rregulluar si obligim kontraktual i mësimdhënësve me të drejta dhe përgjegjësi të plota e të qarta. Në rastet kur vërtetohet se mësimdhënësit kanë bërë shkelje në administrim të testeve, përgjegjësia të reflektojë në kontratën e punës për mësimdhënie e jo vetëm në mëditjen e ditës së testimit;
7. Të ndalohet përdorimi i telefonit celular në sallat ku bëhet testimi. Kjo ndalesë të vlejë pa përjashtim edhe për nxënësit e edhe për administratorët e testit;
8. Administratorët në asnjë moment të mos braktisin klasat ku janë caktuar për monitorim;
9. Rekomandojmë që lista e pjesëmarrësve në Testin e Maturës të publikohet me kohë, në mënyrë që nxënësit të kenë qasje paraprakisht duke e identifikuar veten se a gjinden në listë apo jo, si dhe të kenë kohë që t'i adresojnë vërejtjet, e jo të ngelin para një akti të kryer në fund;
10. Të ketë më shumë disiplinë gjatë testimit (të mos lejohen që të bashkëpunojnë nxënësit gjatë testimit).



# PUBLIKIMET NË LIDHJE ME MONITORIMIN E TESTIT TË MATURËS 2015

## 6 Qershor

MAShT: Ndëshkime për Ata që Zihen me Telefona në Provimin e Maturës  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/MAShT-Ndeshkime-per-Ata-qe-Zihen-me-Telefona-ne-Provimin-e-Matures-6929>

Kosova Gati për Testimin e Dijes së Maturantëve  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Kosova-Gati-per-Testimin-e-Dijes-se-Maturanteve-6866>

MAShT: Përfundon Testi i Maturës  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/MAShT-Perfundon-Testi-i-Matures-6935>

ZBULIMI: Përgjigjet e Testit Shpërndahen Masivisht Online  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/ZBULIMI-Pergjigjet-e-Testit-Shperndahen-Masivisht-Online-6947>

Provim në Prishtinë, Qetësi Absolute  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Provim-ne-Prishtine-Qetesi-Absolute-6951>

Drejtori Bashota Pengon Ekipin e KALLXO.com në Klinikë  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Drejtori-Bashota-Pengon-Ekipin-e-KALLXOcom-ne-Kline-6943>

Ministri Bajrami Falënderon KALLXO.com për Monitorimin e Testit të Maturës  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Ministri-Bajrami-Falenderon-KALLXOcom-per-Monitorimin-e-Testit-te-Matures-6950>

Rahovec, Universitetet Private Shpërndajnë Fletushka Brenda Shkollës  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Rahovec-Universitetet-Private-Shperndajne-Fletushka-Brenda-Shkolles-6937>

Maturanti i Operuar i Nënshtrohet Testit  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Maturanti-i-Operuar-i-Nenshtrohet-Testit-6939>

Përditësuar: Dy Nxënëset në Mitrovicë Lejohen të Hyjnë në Test  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Perditesuar-Dy-Nxeneset-ne-Mitrovice-Lejohen-te-Hyjne-ne-Test-6938>

Mungesë Administratorësh në Gjimnazin "Frang Bardhi"  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Mungese-Administratoresh-ne-Gjimnazin-Frang-Bardhi-6941>

Dy Nxënëse në Lipjan nuk i Gjejnë Emrat në Listat e Testit  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Dy-Nxenesene-Lipjan-nuk-i-Gjejne-Emrat-ne-Listat-e-Testit-6945>

Administruesi me Telefon në Dorë në Gjimnazin 'Frang Bardhi' në Mitrovicë  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Administruesi-me-Telefon-ne-Dore-ne-Gjimnazin-Frang-Bardhi-ne-Mitrovice-6946>

"Vetëm 2 Minuta dhe Jo më Shumë"  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Vetem-2-Minuta-dhe-Jo-me-Shume-6948>

Drejtori 'Disiplinon' Maturantët Para Hyrjes në Test  
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Drejtori-Disiplinon-Maturantet-Para-Hyrjes-ne-Test-6953>

Mungesë Administratorësh në Gjimnazin “Frang Bardhi”

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Mungese-Administratoresh-ne-Gjimnazin-Frang-Bardhi-6941>

Ngatërrohen Listat në Një Shkollë të Prizrenit

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Ngaterrohen-Listat-ne-Nje-Shkollë-te-Prizrenit-6949>

Merren Masa ndaj Shkelësve të Testit të Maturës Shtetërore

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Merren-Masa-ndaj-Shkelesve-te-Testit-te-Matures-Shteterore-7007>

Nesër Publikohen Emrat e Keqpërdoruesve të Testit të Maturës

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Neser-Publikohen-Emrat-e-Keqperdoruesve-te-Testit-te-Matures-6984>

‘Jeta në Kosovë’ Diskutoi për Testin e Maturës

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Jeta-ne-Kosove-Diskutoi-per-Testin-e-Matures-7003>

Testi i Suksesit dhe Ndëshkimit

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Testi-i-Suksesit-dhe-Ndeshkimit-7051>

## 20 Qershor

MAShT Përjashton 67 Maturantë që Keqpërdorën Testin

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/MAShT-Perjashton-67-Maturante-qe-Keqperdoren-Testin-7169>

Përfundoi Testi i Maturës

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Filloi-Testi-i-Matures-7181>

Testi i Sotëm Vlerësohet më i Mirë se në Ditën e Parë

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Testi-i-Sotem-Vleresohet-me-i-Mire-se-ne-Diten-e-Pare-7194>

Përsëri Shpërndahet Testi Online

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Perseri-Shperndahet-Testi-Online-7183>

Ndërpritet Wireless në ‘Frang Bardhi’ pas Raportimit të KALLXO.com

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Nderpritet-Eireless-ne-Frang-Bardhi-pas-Raportimit-te-KALLXOcom-7188>

Maturanti Kërcënon Administruesin e Testit në Ferizaj

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Maturanti-Kercenon-Administruesin-e-Testit-ne-Ferizaj-7193>

Drejtori Bind Maturantin ta Dorëzojë telefonin Gjatë Testi

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Drejtori-Bind-Maturantin-ta-Dorezoje-telefonin-Gjate-Testit-7187>

Dy Nxënëse Përjashtohen nga Testi i Maturës në Mitrovicë (FOTO)

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Dy-Nxenese-Perjashtohen-nga-Testi-i-Matures-ne-Mitrovice-FOTO-7186>

Shkolla e Muzikës në Prizren Fillon Testin me Një Orë e Gjysmë Vonesë

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Shkolla-e-Muzikes-ne-Prizren-Fillon-Testin-me-Nje-Ore-e-Gjysme-Vonese-7190>

**RAPORT NGA MONITORIMI I TESTIT KOMBËTAR TË MATURËS 2015  
AFATI I QERSHORIT 2015**

**Internews Kosova**

"Mensa e Studenteve" Kati i parë,  
Prishtinë 10 000, Kosovë  
[www.internewskosova.org](http://www.internewskosova.org)  
[info@internewskosova.org](mailto:info@internewskosova.org)

Dizajni nga:  
**project.GRAPHICS**